



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 30.10.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)
<i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH).</i>			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (ketu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi I Vettingut të subjektit të rivlerësimit z. Sokol Stojani, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme</i>		
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z. Sokol Stojani</i>		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme</i>		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u zhvillua e plotë, në distancë kohore 30 minuta (12:00-12:33), pa proceduar me shtyrje të saj. Trupa gjyqese e KPK tërhiqet për të marrë vendimin, shpallja e të cilit është shtyrë për ditën e nesërme</i>		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Shpallja e dispozitivit te vendimit eshte shtyre per ditën e nesërme (dt. 31 tetor, ora 13:00)</i>		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Tupa gjyqese (emrat)	<i>Brunilda Bekteshi - Kryetare e trupit gjyqes; Valbona Sanxhaktari - Relatore e çështjes; Suela Zhegu - anëtare e trupit gjyqes; Denisa Korto - sekretare, prezente pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore</i>		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Përfaqësues I Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, z. Ferdinando Buatier de Mangeot, prezent pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore</i>		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Mbrojtje personalisht</i>		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Albana Misja</i>		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Numri I anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 20 persona, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën degjimore. Akomodimi u krye ne formë të rregullt nga stafi koordinues I KPK, pavarësisht se hapësira fizike e godinës nuk mundësonte pjesëmarrje më të lartë në numër. Prezent pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore</i>		
Media e pranishme:	<i>Media lokale ishte e pranishme, me përafërsisht 7 përfaqësues, me akses të plotë ne hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u mundesua vetëm në pjesën e parë të seancës dëgjimore, pa filluar procedura e hetimit administrativ, kohë gjatë së cilës i'u komunikua nga kryetarja e trupit gjyqes, të largohen nga salla.</i>		
	<i>Po/Jo</i>	<i>Nëse po, si u justifikua ai?</i>	<i>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</i>

<p>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vetingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</p>	<p>Po</p>	<p>Trupa gjyqese vendosi të zhvilloj procesin e vettingut bazuar në të tre kriteret ligjore: vlerësimin të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin të aftësive profesionale</p>	<p>Subjekti I rivlerësimin e cilësor metodologjinë e ndjekur të rregullt e të paanshme duke shprehur dakordësi lidhur me procesin e hetimit administrativ dhe raportin përfundimtar. Konfirmohet vënien në dijeni me materialet e dosjes dhe dokumentat provues të hetimit administrativ. Konfirmohet lënia e një hapësire kohore të nevojshme me qëllim dokumentimin përfundimtar me shkrim të pretendimeve, një pjesë të së cilës e komentoj në seancën dëgjimore. Kryesisht gjate pretendimeve vuri theksin tek shpjegimi i rrethanave të faktit të tre denoncimeve të qytetarëve bërë kundër tij.</p>
--	-----------	--	---

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	<p>Të dhënat mbi te ardhurat dhe pronësinë, marrë nga raporti i ILDKPKI dhe hetimi administrativ i pavarur i KPK: 1- Apartament banimi, sipërfaqe 28 m2, me vlerë të deklaruar 5 milion ALL. Burimi i krijimit: kredi pranë Raiffeisen Bank, vërtetuar me Kontratën e Huasë lidhur në vitin 2002, me afat cilrimi 25 vjet. 2- Autoveturë, tip Nissan, prodhim i vitit 2008, që i korrespondon vlerës 4700 EUR. Burimi i krijimit: kursime familjare. 3- Të dhëna mbi të ardhurat e disponueshme nga familjarët e subjektit të rivlerësimit, pas nënshkrimit të deklaratës së deklarimit të pasurisë (persona të tjerë, sipas ligjit): E ëma: nuk disponon pasuri vecmas. I vëllai (Aleksander Stojani), deklaron të ardhura të akumuluar nga kredi bankare, të konfirmuara.</p>	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	<p>Provat e administruara ne seancën dëgjimore: Raporti i ILDKPKI, të dhëna të tjera (deklarata) nga subjekti i rivlerësimit, informacione shkresore marrë nga institucionet publike, dokumenta të tjerë të dosjes. Referohen ne séancë dëgjimore nga Relatorja e trupit gjykues. Komunikuar njohja e tyre subjektit të rivlerësimit (respektuar parimi i aksesit ne gjykim dhe e drejta e mbrojtjes efektive). Deri ne fazën procedurale të shpalljes së dispozitivit të vendimit, nuk mund të arrihet të jepet vlerësim mbi barrën e provës</p>
	<p>Kryesuesja znj. Bekteshi, pasi shpjegon aspektin procedural të ecurisë së seancës dëgjimore, parashtron të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit (në përputhje me N. 55 të ligjit nr 84/2016), konfirmon faktin se subjekti ka marrë dijeni të plotë për dosjen dhe materialet provuese, dhe i jep fjalën Relatores së ceshtjes. Relatorja e çështjes, znj. Sanxhaktari, referon Raportet e ILDKPKI, saktësinë e tyre, dhe konkluzionet përfundimtare sa më poshtë: Subjekti i rivlerësimit ka burim të ligjshëm të të ardhurave, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.</p>	Relatori	
	<p>nuk ka</p>	Mbrojtja	
	<p>Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentat provues. Miraton deklarimet e KPK mbi përfundimet të hetimit administrativ</p>	Subjekti i rivlerësimit	
	<p>nuk ka</p>	Ankesa nga publiku	
<p>Perfaqësuesi i ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit</p>	Perfaqësuesi i ONM		

D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Të dhënat nga raporti i DSIK, verifikimet e grupit të punës dhe hetimet e pavarura të KPK: konstatojnë vlerësimin: "I Përshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës	Të dhëna nga raportet e DSIK	Raporti Drejtorisë së Sigurisë dhe Informacionit të Klasifikuar, dhe verifikimet e grupit të punës
	Relatorja e cështjes, referuar aneksit DH të Kushtetutës, ligjit nr.84/2016, dhe të provave si më sipër, deklaron "Përshtatshëm" në vazhdimin e detyrës. Megjithatë, lidhur me këtë kriter ligjor analiza hetimore ndjekur nga grupi i punës nuk u pasqyrua e plotë. U referua vetëm miratimi i konstatimeve të nxjerra nga DSIK, si e vetmja provë e administruar. Pritet të analizohet pjesa arsyetuese e vendimit përfundimtar për të krijuar bindjen e transparencës hetimore.	Relatori	
	nuk ka	Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentat provues. Miraton deklaratimet e KPK mbi përfundimet të hetimit administrativ	Subjekti i rivlerësimit	
	nuk ka	Ankesa nga publiku	
	Perfaqësuesi i ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Perfaqësuesi i ONM	
	Të dhënat marrë nga Prokuroria e Përgjithshme, për periudhën e vlerësimit Tetor 2013-2016: 1- Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, vendos: Aftësi të plota në organizimin me efektivitet të punës. 2- Vlerësimi i punës nga Prokurori i Përgjithshëm: vlerësimi "shumë mirë". 3- Të dhëna nga sektori i Burimeve Njerëzore: kundër subjektit të rivlerësimit nuk është marrë asnjë masë disiplinore.	Të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme	Provat e administruara në séancë dëgjimore: Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme; Vlerësimi i punës nga Prokurori i Përgjithshëm; të dhëna marrë nga sektori i Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme; të dhëna nga denoncimet e qytetarëve.

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Relatorja parashtrohet burimin e të dhënave dhe vlerësimin përfundimtar të tyre: 1- Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, vendos: Aftësi të plotë në organizimin me efektivitet të punës. 2- Vlerësimi i punës nga Prokurori i Përgjithshëm: vlerësimi "shumë mirë". 3- Të dhëna nga sektori i Burimeve Njerëzore: kundër subjektit të rivlerësimit nuk është marrë asnjë masë disiplinore. 4- Të dhëna mbi ankesat e qytetarëve: 7 denoncime. 5- Relacioni nga procedura e hetimit të KPK: bashkëpunues në proces	Relatori		
	nuk ka	Mbrojtja		
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentat provues. Miraton deklaratimet e KPK mbi përfundimet të hetimit administrativ	Subjekti i rivlerësimit		
	nuk ka	Ankesa nga publiku		
	Perfaqësuesi i ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Perfaqësuesi i ONM		
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit z. Sokol Stojani, plotëson kriteret që referon ligji nr 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative dhe Aneksi shtojcë i Kushtetutës. Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku është respektuar. Pjesëmarrja e medias lokale është kufizuar në pjesën hyrëse të seancës dëgjimore. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt. Referohet informacioni i plotë mbi procedurën e hetimit administrativ të KPK, dhe mbi provat e administruara. Konfirmohet njoftimi (6 ditë para zhvillimit të seancës) e dosjes dhe provave të administruara subjektit të rivlerësimit, i materialeve provuese dhe datës së seancës dëgjimore në kohë për të mundësuar të drejtën e mbrojtjes efektive. I parashtrihen në formë shteruese të drejtat procedurale, duke përfshirë edhe të drejtën e mbrojtjes, të cilën subjekti ka gjykuar ta ushtrojë personalisht. Deklarohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka konflikte interesi me anëtarët e trupës gjykuese të KPK, dhe se i është njohur e drejta e paraqitjes së provave. I mundësohet e drejta e fjalës dhe parashtrimit të shpjegimeve, në respektim të parimit të kontradiktoritetit. I mundësohet e drejta e pyetjes subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit ndërkombëtar të pranishëm. Kohëzgjatja e seancës dëgjimore është e arsyeshme (33 minuta). Trupi gjykues tërhiqet për shpalljen e dispozitivit të vendimit në dt. 31 tetor, ora 13:00.			